



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**LEGJISLATURA VIII**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Mbledhja nr.79

Prishtinë, më 13.05.2024, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Bekë Berisha, kryetar i Komisionit Enver Dugolli- nënkryetar i parë, Shqipe Mehmeti Selimi, Mefail Bajqinovci, Dimal Basha, Rashit Qalaj, Hisen Berisha, anëtar.

**Mungoi:** Erxhan Galushi - nënkryetar i dytë, Arbër Rexhaj Anton Quni,-anëtar.

**Përfaqësuesit e Inspektoratit Policor të Kosovës:** Kushtrim Hodaj-Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së, Bardhyl Haxhimustafa- Udhëheqës i Divizionit për Hetimin e Korrupsionit dhe Krimin të organizuar

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Faton Krasniqi- ndërlidhës legjislativ mes Kuvendit dhe Ministrisë së Mbrojtjes, Besnik Fetahu (Grupi parlamentar i VV), Laurenta Zogaj-Asistente në Komisionin Parlamentar

**Nga stafi mbështetës i komisionit:** Nur Çeku (koordinator), Zarë Aliu (zyrtare e lartë)

**Mbledhjen e kryesoi Bekë Berisha,** kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit e mbajtur me datë 26.03.2024;
3. Raportimi i Kryeshefit Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës z.Kushtrim Hodaj për raportin vjetor të punës për vitin 2023;
4. Të ndryshme.

Në vijim të mbledhjes u kalua në shqyrtimin e pikave të rendit të ditës.

**Kryetari**, të nderuar deputet, duke qenë se end nuk e kemi kuorumin për fillimin e mbledhës, fillojmë më dëgjimin e Kryeshefi të IPK-së, dhe më pas kur të jetë kuorumi e miratojmë rendin e ditës dhe vazhdojmë me pikat e tjera.

### **3. Raportimi i Kryeshefit Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës z.Kushtrim Hodaj për raportin vjetor të punës për vitin 2023.**

**Kryetari**, i nderuar Kryeshef i Inspektoratit Policor të Kosovë z.Hodaj, i nderuari z.Haxhimustafa-Udhëheqës i Divizionit për Hetimin e Korrupsionit dhe Krimin të organizuar, ashtu siç edhe ju kemi njoftuar përmes e-mailit, ju kemi ftuar në raportim lidhur me ndryshimet e bërë në Njësinë e Hetimeve në Policinë e Kosovës, por duke qenë se në plan të punës e kemi pasur edhe raportimin e juaj për raportin vjetor të punës, sot do të jetë edhe raportimi i juaj për raportin vjetor të punës për vitin 2023. Fillimisht i nderuar Kryeshef, do të doja që të fillonim me raportimin për zhvillimet e fundit në Policinë e Kosovës, në Njësinë e Hetimeve, pastaj vazhdojmë me raportin vjetor të punës për vitin 2023.

**Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së**, faleminderit Kryetar dhe anëtar të Komisionit, konsiderojmë që viti 2023 ka qenë një vit i përmbushjes së objektivave tona, falë edhe bashkëpunimit me qytetar, nga Ministria dhe partnerët, ku veçoi mbështetjen e dhënë nga ICITAP-i dhe Qeveria Amerikane. Janë ndërmarrë veprime pro aktive në përmirësimin e shërbimeve të policimit përmes inspektiveve në rritje si dhe aktivitete reaktive në hetimin veprave penale, nën dyshimin se zyrtar të policisë janë të përfshirë në vepra penale. Lufta kundër korrupsionit, vazhdon të jetë një nga prioritetet tona, drejt fuqizimit të një policie me integritet, ku përmes angazhimeve tona, kemi arritur të rrisim nivelin e besueshmërisë tek qytetarët dhe partnerët, konstatim ky që ka dalë nga organizatat e shoqërisë civile dhe nga mekanizmat ndërkombëtar. Duhet të theksojmë vlerësimin nga Departamenti Amerikan i Shtetit në vitin e kaluar, për ndarjen e çmimit për sukses të jashtëzakonshëm operacional, bashkëpunimi vendor, rajonal dhe ndërkombëtar me agjencitë ka qenë pjesë e agjendës sonë dhe kjo reflekton angazhimin tonë në këtë fushë, falë kontributit dhe përkrahjes së partnerëve, u mundësua krijimi i një mekanizmi të përbashkët në luftimin e krimin ndërkufitar dhe IPK-ja, ka rol të rëndësishëm për funksionalizimin e Forumit Rajonal të Agjencive Mbikëqyrëse Policore, i cili është themeluar vitin e kaluar dhe i cili është funksional si një mekanizëm i përbashkët i agjencive mbikëqyrëse, për shtet si Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, gjithashtu është arritur nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Inspektoratin gjeneral e forcave të përgjithshme të Republikës Çeke, janë pjesë aktive e mekanizmit Evropian, Partnerët Evropian kundër korrupsionit, gjithashtu jemi pjesë përbërëse në Shoqatën e mekanizmave të hetimeve të brendshme në ShBA si anëtar i barabartë.

Në vazhdim do ti paraqesim disa informata të përmbledhura nga performanca e organizatës, në të gjitha drejtimet bazuar në mandatin ligjor të IPK-së. Jemi angazhuar që të rrisim besimin qytetar në sistemin e trajtimit të ankesave, kemi pranuar dhe administruar 1697 ankesa gjatë viti 2023 të pranuar në mënyra të ndryshme nga qytetarët. 30% të tyre janë orientuar për trajtim penal, të cilat janë trajtuar nga Drejtoria e Hetimeve në IPK, ndërsa pjesa tjetër prej 68% janë orientuar për trajtim disiplinor apo administrativ në divizionin e hetimeve të brendshme. Jemi angazhuar në luftimin dhe parandalimin e krimit dhe keq menaxhimit policor, kemi hetuar 178 të dyshuar, ku 156 punonjës policor dhe 22 qytetar që kanë qenë në raste të përbashkëta me zyrtar policor. Kemi ngritur 74 kallxime penale ndaj të dyshuarve për veprimtari kriminale, kemi arrestuar 35 punonjës dhe qytetar nën dyshimin për përfshirjen në vepra të ndryshme kriminale dhe kemi rekomanduar suspendimin e 72 punonjësve policor. Përmes aktiviteteve tona, kemi ndihmuar në përmirësimin e aktivitetit të policimit, duke realizuar inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme të bazuara në analiza të thella dhe të gjeturat në fushat e menaxhimit policor. Kemi kontrolluar qindra dosje administrative, penale, financiare dhe dosje të prokurimit, qindra intervista, kemi rekomanduar avancimin e punës, efikasitetit, performancës së policisë, përmes dhënies së 126 rekomandimeve për përmirësim të punës në Policinë e Kosovës, janë verifikuar përmbushja e rekomandimeve në fusha e ndryshme të inspektuara më parë.

Si më poshtë do të listoj inspektimet e realizuara në vitin 2023, kemi inspektuar fondin emergjent të policisë së Kosovës, kemi vlerësuar performancën e Stacionit Policor të Obiliqit, Gjakovës, kemi inspektuar shqyrtimin e lëndëve për shkelje disiplinore dhe shqiptimin e masave nga Komisioni disiplinor në kuadër të policisë, kemi vlerësuar performancën e stacionit policor të Ferizajt dhe Klinës, kemi inspektuar vlerësimin zbatimit të marrëveshjeve ndërmjet Këshillit të Ministrave mes republikës së Shqipërisë dhe republikës së Kosovës në lidhje me pikta e përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë në kryerjen veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar, kemi inspektuar trajtimin e dhunë në familje nga policia e Kosovës, kemi inspektuar vlerësimin e performancës së stacionit policor të Malishevës, menaxhimin e trafikut rrugor në kryeqytet, vlerësimin e performancës së stacionit policor të Istogut dhe Fushë Kosovës si dhe një inspektimi jashtëzakonshëm në parandalimin e aktiviteteve në parandalimin e garave të shpejtësisë së automjeteve, gjithashtu jemi angazhuar në sensibilizimin e qytetarëve dhe rritjen e transparencës, kemi publikuar 64 komunikata, 180 kërkesa janë dhënë për mediat, janë realizuar takime me qytetar, forume të sigurisë dhe institucionet e ndryshme, kemi hartuar dokumente të nevojshme, akte nënligjore, për funksionimin sa më të mirë të organizatës. Këto janë aktivitet e përmbledhura në mënyrë të shkurtër.

**Kryetari**, atëherë me që u bë kuorumi, të miratojmë rendin e ditës dhe vazhdojmë me pyetjet e anëtarëve të Komisionit.

## **1. Miratimi i rendit të ditës.**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit e mbajtur me datë 26.03.2024.**

**Kryetari**, a ka vërejtje për këtë procesverbal? Nëse jo konstatoj miratimin e procesverbalit.

**Kryetari**, i nderuar Kryeshef, të falënderoj për raportimin, këto informacione i kemi marrë edhe të shkruara. Kam pasur shumë kërkesa edhe nga mediat për procesin e gradimit. A keni informacion se si ka shkuar ky proces? A ka hetuar IPK-ja, hetuesit që janë marrë me rastin e rezervave shtetërore? Shefi aktual i hetimeve në Policinë e Kosovës z.Berisha, është hetuar një herë nga IPK-ja, për një çështje dhe ka dalur që e ka ngrit vet dhe nuk ka dalur ndonjë shkelje dhe aktualisht është Drejtor i Njësisë së veçantë të Hetimeve? Pas ndryshimeve në sektorin e hetimeve, është përmendur edhe një listë e shkarkimeve të disa të tjerëve, tash pritet që nga presioni disa të japin dorëheqje dhe disa të largohen. Pra janë zyrtar që kanë filluar hetime për rastet e korrupsionit në nivelin e lartë. Ka reaguar edhe prokurori për këtë ndryshim, duke u thirrur si një reformë? Si e shihni këtë proces?

**Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së**, në përgjigjeje të pyetjeve të Kryetarit, theksoi se sa i përket konkursit për avancim për gradën rreshter, theksoi se IPK kanë pranuar një numër të ankesave anonime për parregullsi në proces, pastaj bazuar në publikimin që ka qenë në media, lidhur me dyshimin nëse një gjeneratë e policisë, kanë pasur apo jo të drejt ti nënshtrohen këtij konkursi, ne kemi krijuar një ekip hetimore dhe do ti trajtojmë të gjitha ankesat dhe gjithashtu do të realizojmë një inspektim të jashtëzakonshëm, për të verifikuar procedurat prej momentit të shpalljes së konkursit për rreshter, deri në fazën aktuale. Do ti grumbullojmë të gjitha informacionet dhe dëshmitë që kemi dhe do të ju sigurojmë lidhur me këtë proces dhe në fund do të dalim me një raport dhe rekomandime për komplet procesin. Lidhur me hetuesit e Task Forcës, IPK-ja ka hetuar hetuesit e kësaj njësie, që kanë qenë duke e hetuar rastet e korrupsionit. Ne kemi pranuar një ankesë nga Ministria e Tregtisë, Industrisë dhe Ndërmarrësisë, njëherë tek Drejtori i Policisë dhe më pas në IPK, për të verifikuar nëse zyrtarët e njësisë së task-forcës, që kanë kërkuar informacione të klasifikuara a posedojnë certifikatën e sigurisë. E kemi trajtuar këtë ankesë, jemi konsultuar me prokurorët e Prokurorisë speciale, kemi hartuar një raport me informacione që kemi marrë në këtë proces dhe ka qenë vlerësim i Prokurorisë se të gjitha veprimet që kanë ndërmarrë hetuesit kanë qenë të koordinuara dhe me autorizim të prokurorit dhe hetuesit kanë qenë të përgatitur dhe të pajisur me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet për të hetuar rastet përkatëse dhe nuk është marrë ndonjë masë ndaj zyrtarëve.

**Kryetari**, pra Ministria është ankuar?

**Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së** pyetja që është bërë ka qenë nëse hetuesit kanë certifikatë të sigurisë? Hetuesit kanë pasur certifikata të nivelit konfidencial, por nga ana e Prokurorit është thënë që ky nivel nuk është pengesë për të zhvilluar hetimet, që i kanë marrë sipas udhëzimeve sipas prokurorit përgjegjës.. Lidhur me shefin aktual të task-forcës, nuk ka informacion nëse është hetuar.

**Bardhyli Haxhimustafa**, theksoi se shefi aktual Besim Berisha është hetuar në vitin 2017-2018, gjithashtu edhe Shemsi Haziri, rekomandimi ka qenë për transferimin e tyre. Hetimi ka qenë për një

parcelë në Hajvali rreth Universitetit Amerikan por ka përfunduar hetimi dhe është paraqitur raporti final, Vendimi i Prokurorisë është thënë që nuk ka elemente të veprës penale.

**Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së**, sa i përket listës së largimeve ose lëvizjeve në këtë njësi, theksoi se nuk kanë pasur hetim tjetër në këtë njësi dhe nuk kanë rekomanduar asnjë transfer ose largim. Ndërsa lëvizjet e brendshme që bëhen janë kompetencë e menaxhmentit të policisë. Nuk kanë pranuar asnjë ankesë nga zyrtarët e kësaj njësie për presion për largimin nga kjo njësi.

**Kryetari**, atëherë u bëj thirrje të gjithë atyre zyrtarëve policor, që e konsiderojnë që kanë presion për tu larguar nga njësi e hetimit të veçantë, të paraqesin ankesën në IPK.

**Enver Dugolli**, faleminderit për raportin vjetor dhe raportimin për çështjet e ngritura. Edhe ne jemi të shqetësuar me raportimet e dala për rekrutimin fundit për gradën rreshter. Ju inkurajojmë që të vazhdoni dhe të shikoni këtë proces, në mënyrë që mos të ketë dilema nga askush. Pasi nuk na duhet një proces që ka dilema, edhe pse duket që diçka nuk ka shkuar ën rregull. Do të besojmë në rezultate që do të dalin pas hetimit në këtë proces në mënyrë që të kemi një rezultat, pa dashur të paragjykojmë këtë proces.

Ajo çfarë doli nga ky takim, dua të kem një sqarim rreth asaj që Prokurori ka konstatuar që nuk ka shkelje ligjore. Por neve na intereson, si ka qenë raporti i juaj, në raport me atë hetim? Pasi askush nuk mund të dalë mbi ligjin, pasi nëse ka qenë e cekur që duhet të ketë certifikatën e sigurisë të nivelit sekret, atëherë marrja me lëndët e nivelit sekret me certifikatë të sigurisë të nivelit konfidencial, nuk është në rregull.

**Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së**, konstatimi ynë ka qenë që hetuesit kanë pasur certifikatën e nivelit sekret, ndërsa dokumentacioni i ministrisë ka qenë i nivelit sekret. Problemi është që çdo hetim që e iniciojmë, e marrim autorizimin nga Prokurori për të ndërmarr veprime hetimore. Qëndrimi i Prokurorit ka qenë që për nevoja atë hetimit, Kodi i Procedurës Penale nuk parasheh këto lloj kufizimesh, për efekt të hetimit dhe të gjitha veprimet e zyrtarëve policor kanë qenë konform dispozitave të procedurës penale.

**Bardhyl Haxhimustafa**, Udhëheqës i Divizionit për Hetimin e Korrupsionit dhe Krimin të organizuar të njëjtin raport për rastin në fjalë, e kemi dërguar edhe tek Prokurori i Shtetit, pra kemi vërtetuar që zyrtarët hetues të task forcës, kanë certifikatë të nivelit konfidencial, ndërsa informacioni ka qenë i nivelit sekret.

**Enver Dugolli**, faleminderit për punën e juaj, pra Prokurori ka dalë mbi ligjin. Pasi Ligji për Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimit të Sigurisë e sqaron këtë gjë.

**Rashit Qalaj**, të lutem mos e keqpërdor foltoren z.Dugolli, pasi është mendim i juaji personal. A mundet Kryeministri të klasifikoj dokumente?

**Mefail Bajqinovci**, i nderuar Kryeshef, kemi pasur në raportim edhe Drejtorin e Policisë. A i plotëson kriteret për gradim zyrtarët policor të gjeneratës së 54 për gradën rreshter, që është në proces tani, pasi ende nuk i kanë mbushur dy vite si polic i lartë, ashtu siç është ën udhëzimin administrativ? Drejtori i policisë tha që për shkak të zgjatjes së shkollimit në Akademi. A keni përgjigjeje për këtë çështje?

**Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së**, në përgjigjeje të pyetjes së z.Bajqinovci, theksoi se kjo është arsyeja që kanë vendosur të bëjnë inspektim të jashtëzakonshëm, akoma nuk e kemi një raport, pasi javën e kaluar e kemi krijuar ekipin për të inspektuar këtë proces. Krahas trajtimit të ankesave që kemi pranuar, njërën prej pikave që do të zbardh ky hetim, është nëse ata kanë të drejtë të garojnë për këtë gradë apo jo. Pasi rregullativa kërkon që ata duhet të kenë dy vite përvojë punë si polic i lartë, që me gjasë kjo gjeneratë nuk e ka. Raporti do të jetë publik dhe do të shihni.

**Mefail Bajqinovci**, i nderuar Kryeshef, e përmendet që keni inspektuar stacionet policore si, Ferizaj, Obiliq, Malishevë, Fushë Kosovë, çfarë keni gjetur, cilat janë problemet kryesore dhe cilat janë shqetësimet më të mëdha të qytetarëve ndaj policisë? A do ti inspektoni stacionet policore në Prishtinë? Sa është koha e veprimit të policisë së Kosovës në Prishtinë por edhe në qytetet e tjera, kur kërkohet ndihëm nga qytetarët?

**Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së** theksoi se janë në proces të monitorimit në stacionet policore në Prishtinë, ndërsa s ai përket komunave të tjera, raporte janë publike bashkë me rekomandimet. Ne i inspektojmë kushte, pajisjet, mënyrën se si trajtohen rastet, kohën e reagimit kur ka thirrje nga qytetarët. Stacionet ballafaqohen me disa mungesa, që janë teknike, mungesa e automjeteve, teknologjisë, pajise për uniformë, sprejve. Mesatarja e reagimit të policisë është rreth 13 minuta por ndryshon sa është larg nga ku merret thirrja.

**Enver Dugolli**, duke qenë se u përmend nga z.Qalaj, se kush ka të drejtë që të klasifikoj informacione, Neni 5 i Ligjit për Klasifikimin e informacionit thotë që, autoriteti i klasifikimit ushtrohet nga Presidenti, kryetari i Kuvendit, anëtarët e Kryesisë së Kuvendit, të Qeverisë, anëtarët e Gjykatës Supreme, Kryeprokurori i Shtetit, Drejtori i AKI-së, Komandanti i FSK-së, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe udhëheqësit e institucioneve të pavarura. Do të thotë që Ministri ka të drejtë të bëjë klasifikimin e një dokumentacioni.

**Kryetari**, pasi qenka kështu puna për certifikatën e sigurisë, Ridvan Muharremi(furraxhiu) a ka pasur certifikatën të sigurisë?

**Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së** sa i përket pyetjeve të z.Bajqinovci, theksoi se 1700 ankesa që ne i trajtojmë gjatë vitit, 5 shkelje i nxjerrim si mesatare deh janë kryesisht shkelje që kanë të bëjnë me keqtrajtim, shkaktim të lëndimit trupor, komunikim jo i duhur me policinë me qytetarë, neglizhim të hetimeve për rastet që paraqesin ën polici, neglizhim të detyrës zyrtare. Gjithashtu është edhe pjesa që lidhet me kundërvajtje dhe tiketa, pro ka ankesa në këtë drejtim dhe ne i drejtojmë tek organet gjegjëse.

**Rashit Qalaj**, faleminderit Kryeshef dhe z.Haxhimustafa për këtë raportim. Nga raport e pamë një aktivitet të mirë, pamë që keni bërë 74 kallxime penale, 35 të arrestuar, 54 me raporte të veçanta dhe 56 me raport informues. Nuk është e lehtë të jesh punonjës i IPK-së, pro detyar e juaj është që të ndihmoni policinë dhe të gjitha dyshimet ti trajtoni ashtu siç duhet. Pajtohet që përderisa nuk ka një ankesë nga zyrtarët që kanë qenë në njësinë e task-forcës, nuk keni se si ta trajtoni dhe këto pretendime nga ana e tyre janë shqetësuese, por deri sa nuk ka diçka jemi ok. Sa i përket çështjes së certifikatave të sigurisë, kjo pjesë është dashur të kryhet nga Drejtori i Policisë, por pjesa e dytë e hetimit është tek Prokuroria dhe më erdhi mirë që z.Haxhimustafa e dha një sqarim se raporti i është dërguar edhe Kryeprokurorit të shtetit. A kanë kthyer diçka me shkrim.

**Bardhul Haxhimustafa**, Udhëheqës i Divizionit për Hetimin e Korrupsionit dhe Krimin të organizuar nuk kemi diçka me shkrim.

**Rashit Qalaj**, sa i përket blerjes së rezervave shtetërore, theksoi se ata janë thirrur në rregulloren për blerjen e pajisjeve ushtarake dhe nga këtu është defekti ligjor. Në bazë të kësaj rregullore, për pajisje të sigurisë janë titullarët e institucioneve që kanë të drejtë të klasifikojnë por jo niveli politik. Neni i fundit i kësaj rregullore, tregon që secili individ që është i përfshirë në blerje për shmangien e rregullave të prokurimit, duhet të ketë certifikatën përkatëse. Pra shkelja ka qenë pasi janë thirrur në rregullore dhe jo në ligjin që e përmendi z.Digolli.

Në lidhje me procedurat e brendshme ndaj inspektorëve të IPK-së, a keni ndonjë masë, transfer apo hetim? Është mbushur vendi me makina me drita të katërta me rotacion, duhet të kemi një inspektim për të parë se sa leje janë lëshuar? Pasi shohim qytetar, përfaqësues të partive politike, shiten kudo, kërkoj të bëhet një hetim për disa polic hetues dhe inspektor të IPK-së, arsyen dhe fushën pse do e dërgoj me e-mail tek ju.

**Kushtrim Hodaj**, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së, në përgjigjeje të pyetjeve të z.Qala, theksoi se sa i përket masave ndaj pjesëtarëve të IPK-së theksoi se e kanë udhëzimin administrativ, ka pasur disa ankesa që kanë ardhur për disa hetues, janë trajtuar dhe nuk ka pasur raste që janë ndërmarr masa. Sa i përket dritave rrotative, theksoi se nuk kanë pasur informacion, ndërsa do të jetë një nga aktivitetet e inspektimeve të radhës nga IPK-ja dhe numri i lejeve që janë dhënë nga policia.

**Rashit Qalaj**, ka shumë ankesa të zyrtarëve policor, që shumë zyrtar që punojnë në IPK, nëse i ndalojnë anëtarët e familjes, shokët, miqtë etj, u hakmerren pastaj dhe dalin jashtë mandatit et një zyrtari.

**Hisen Berisha**, falënderoi për raportimin Kryeshefin. Tutje thekso se ne si deputet, nuk duhet të dalim me konstatime se dikush ka dalë mbi ligjin dhe distancohem nga kjo. Ndërsa sa i përket referimet të Ligjit për klasifikimin e informacionit, tregon se cilat janë autoritet. Sa i përket blerjeve konfidenciale, janë blerje që janë në fushën ushtarake dhe të inteligjencës, por blerjet konfidenciale janë temë e veçantë. Shqetësuese është që, hetimi nuk ka të bëjë vetëm me shërimin e shqetësimit ligjor që kemi ne, shqetësuese është paraqitja në media dhe më pas në opinionin publik. Në raportimin në media, është thënë që janë suspenduar udhëzuesit administrativ, pa u bërë ende udhëzuesit e ri, me qëllimin e vetëm që tu mundësohet një gjeneratë të aplikojnë për rreshter, pasi

janë të filtruar partiakisht. Ndërsa në rastet ku janë zhvilluar hetime për disa zyrtar policor, sic ka qenë rasti në Qafëprush, çfarë ka ndodhur me ta? Duhet të punoni që të ruani edhe imazhin e institucionit në publik, pasi politika është egoiste.

**Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së,** theksoi se për shkak të ngritjes së shqetësimit në publik dhe informacionet që kanë marrë, kanë filluar me procesin e hetimit për procesin e gradimit. Për këtë do të bisedojmë edhe me menaxhmentin e policisë, që të pezullonë këtë proces, në mënyrë që mos të ketë pengesa më vonë. Sa i përket ankesave nga zyrtarët të njësisë së hetimit të veçantë, pa bërë ankesa ne nuk mund ti dimë shqetësimet e tyre. Ndërsa sa i përket arrestimeve të bëra në dy pika kufitare, Morinë dhe Qafprush, kanë qenë arrestime me udhëzim të prokurorit 48 zyrtar policor, 2 doganier, 26 në pikën kufitar në Morinë. Për numrin më të madhtë këtyre zyrtarëve kemi ofruar prova, për një numër më të vogël, diku 8 zyrtar, kanë qenë neglizhent dhe lejimit të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, por për secilin prej tyre është filluar procedurë administrative. Pasi në disa raste mjafton neglizhenca kur ke përgjegjësinë, për disa janë marrë masa ndërsa disa janë në proces.

**Rashit Qalaj,** sa i përket inspektimit dhe hetimit të procesit të gradimit, nga një sistem i avancuar, ku rezultatin ke pasur mundësi ta marrësh menjëherë, është kthyer në test me shkrim, pse?

**Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së,** theksoi e edhe ky aspekt do të trajtohet, cila ka qenë baza ligjore

**Mefail Bajqinovci,** u përmendën edhe gradimet politike, gjenerata e 54 a janë fëmijë të eprorëve të policisë? Nëse është ashtu, të shohim se fëmijët e kujt janë ata?

**Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së,** ka pasur ankesa që është thënë që kanë lidhje familjare dhe në raport do të pasqyrohen të gjitha.

**Hisen Berisha,** sa i përket traditës në profesione, nuk ka asgjë të keqe dhe duhet të krijohet kjo traditë, nuk duhet të paragjykohet, por jo me rrugë korruptive dhe duhet të eliminohen.

**Mefail Bajqinovci,** pajtohem që mund të ketë, por nuk mund të jenë katër zyrtar policor vëllezër, por edhe motra.

**Shqipe Mehmeti Selimi,** faleminderit Kryeshef për raportimin, raporti i juaj është për çdo lavdat dhe ju pagëzoj, Gjithashtu ju uroj për vlerësimin e dhënë nga Departamenti i Shtetit për punën e juaj, dhe ju inkurajoj të bëni punë si deri më tash. Kolegët nga opozita, mundohen që të nxjerrin diçka që i përket Prokurorisë por edhe nga ju. Luteni që çfarëdo që keni të thonë dhe të jeni të hapur. Ne e dimë që Qeveria jonë nuk e pengon procesin dhe nuk e fsheh askënd nga veprat e bëra, pasi kjo Qeveri nuk e shfrytëzon pushtetin për fshehjen e krimeve. Ndërsa sa i përket raportit të juaj, thuhet që keni bërë vizita në disa stacione policore, dhe pyetjet kanë qenë të zgjedhura në mënyrë rastësore, janë zhvilluar intervista me gjashtë zyrtar policor. Rekomandimet e dhëna nga ju, ne si Komision duhet ti kemi, pasi ne si deputet kemi ankesa. Andaj ju lutem që të na e dërgoni gjetjet dhe rekomandimet e dalura nga inspektimet e bëra në stacionet policore.



**Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së,** theksoi e të gjitha ato që duhet thënë, i kanë adresuar. Ndërsa sa i përket inspektimit të stacioneve, thekso se i kanë protokollat e veçanta se si i bëjnë inspektime. Tutje theksoi se nga viti i kaluar kanë shkuar me inspektime të shkurtra, në mënyrë që të pasqyrohet gjetja reale dhe për secilin zyrtar përgjegjës. Rekomandimet e inspektimeve janë të publikuara, përveç ato që janë të klasifikuara që nuk publikohen. Gjithashtu kemi bërë një lëvizje, kemi futur një mekanizëm të mbikëqyrjes së rekomandimeve, që i jep IPK-ja, jemi në proces që ky mekanizëm të jetë në zbatim, në mënyrë që të rritet niveli i zbatimit të rekomandimeve.

**Shqipe Mehmeti Selimi,** sa ka qenë efektive ky procesi i mbikëqyrjes së rekomandimeve?

**Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së,** ka qenë efektive pasi kjo ka nxitur që policia të merr masa për zbatimin e tyre, ku disa prej rekomandimeve kanë edhe implikime financiare. IPK-ja, ka si qëllim që të përmirësoj punë e policisë, përmirësimin e kushteve të punës, etj.

**Shqipe Mehmeti Selimi,** ju lutem Kryeshef, a keni ndërhyrje nga politika në punë e juaj, nëse keni, ju lutem të tregoni?

**Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së,** si IPK, kemi arritur që të krijojmë një pavarësi politike dhe nuk kemi pengesa, por sigurisht kemi nevojë për përkrahje financiare nga ana e politikës.

**Mefail Bajqinovci,** i nderuar Kryeshef, një ankesë është për Qendrat e masazhit në Prishtinë, pasi ka mundësi që zhvillohet prostitucion dhe ka dyshime që ka zyrtar policor që fshihen mbrapa tyre?

**Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së,** kemi informacione që dyshohet që mund të jenë të përfshirë zyrtar policor, kemi edhe raste që janë në trajtim dhe janë duke u proceduar.

**Hisen Berisha,** sa i përket kushteve të punës së policisë, theksoi se është shokuar nga kushtet e punës, të cilat ishin të mjerueshme, pra fjala është për stacionin policor në Gjakovë.

**Shqipe Mehmeti Selimi,** i nderuar Kryeshef, dhuna në familje zakonisht raportohet në polici, ankesa më e madhe është që zyrtarët që e pranojnë rastin e neglizhojnë dhe viktimën e nënçmojnë, ose i thonë që mirë ua kanë bërë. A kemi raste në hetim sa i përket kësaj çështje për zyrtar policor që punon në këtë sektor? Në qytetet e mëdha mund të ketë raportime, por në zonat e thella kjo çështje është problematike dhe stigmatizohet dhe kjo çështja është brengosëse dhe është e pafalshëm nëse IPK-ja nuk merr masa, për ata zyrtar policor që e neglizhojnë detyrën tyre. A ka proceduar standarde për paraqitjen e dhunës në familje?

**Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së,** në përgjigjeje të pyetjes së znj. Mehmeti Selimi, theksoi se nga IPK-ja, vitin e kaluar është kryer një inspektim, për të parë kapacitetet, procedurat dhe janë dhënë rekomandimet se si duhet bërë kjo punë. Por kemi raste kur edhe vet zyrtarët policor përfshirë në dhunën në familje. Policia ka ende hapësirë për përmirësimin e kësaj fushe, pasi është fushë e ndjeshme dhe specifike. Sa i përket asaj nëse ka procedura, theksoi se janë protokolle të veçanta dhe rekomandohet të jenë edhe dhomat e veçanta, që qytetari të ndjehet rehat, kemi

rekomanduar edhe byzylykët për ata persona që kanë masa të gjykatës, që i siguron viktimat dhe janë edhe si rekomandime të tjera. Mbetet që ne ti inspektojmë deh rekomandimet po zbatohen

**Rashit Qalaj**, sa i përket dhunën s në familje, kërkoi që të ketë konfidencialitet që kur paraqitet rasti të mos bëhen publike, pasi nuk krijon siguri tek vitkima.

**Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së**, për çdo rast që e identifikojmë, marrim masa dhe jemi gjithmonë të gatshëm.

**Kryetari**, faleminderit Kryshef për raportimin në Komision, jeni të liruar nga ky takim.

### **3. Të ndryshme.**

Nëse nuk a çështje për të diskutuar e konsideroj takimin e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i Komisionit.**

**Bekë Berisha,**  
**Kryetar i Komisionit**

---

